

Prof. Dr. Alush Musaj

Rektor i Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë

Profesor Alush Musaj është rektori i parë i Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM), fillimisht si ushtrues detyre prej vitit 2013, kur është themeluar Universiteti, ndërsa në vitin 2015 është zgjedhur rektor në zgjedhjet e rregullta. Prof. dr. Alush Musaj në vitin 2019 në zgjedhjet e përgjithshme të UIBMsë është rizgjedhur rektor edhe për një mandat tjetër.

Musaj është i lindur në vitin 1970 në Lubizhdë të Hasit. Studimet themelore, master dhe ato të doktoraturës i ka kryer në Universitetin Bujqësor të Tiranës. Ka doktoruar në vitin 2010 me punimin “Aplikimi i sistemit HACCP”.

Profesor Musaj, karrierën e tij në hulumtim dhe mësimdhënie e filloi në Universitetin e Prishtinës në vitin 2006. Ai filloi si asistent i angazhuar në këtë universitet, në vitin 2007 është zgjedhur asistent i rregullt, ndërsa në vitin 2010 profesor asistent. Thirrjen tjetër akademike profesor i asocuar e mori në vitin 2014 në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë, dhe së fundmi thirrjen profesor i rregullt e mori poashtu në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë, në vitin 2018.

Fokusi kryesor kërkimor i profesor Musaj është në teknologjinë e ushqimit, përkatësisht në kontrollin, cilësinë dhe sigurinë e ushqimit. Është autor dhe bashkautor i shumë punimeve shkencore ndërkombëtare.

Përvoja e tij menaxheriale si prodekan për çështje akademike, koordinator, konsulent/ekspert, drejtor, në institucione të ndryshme, kombinuar me karakterin entuziast, motivim të lartë, ambicie e dinamizëm, është një pasuri e krijuar nga vite të gjata pune intensive. Ndërsa si rektor, Musaj, ka arritur për një kohë të shkurtër ta bëjë Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë, një nga universitetet më të konsoliduara në vend. Rektori Musaj është fokusuar në përmirësimin e kushteve të punës për studentë dhe mësimdhënës, në rritjen e cilësisë së punës akademike si dhe përmirësimin dhe lehtësimin e shërbimeve administrative për studentë. Ai ka promovuar bashkëpunimin me universitete kombëtare dhe ndërkombëtare, duke krijuar mundësi të mëdha për shkëmbime në fushën akademike.